

Disa propozime për ndryshimin e zonimit dhe Planin e Menaxhimit të PK Prespë (Duke përfshirë edhe shpatet perndimore të Malit të Thatë).

Parku Kombëtar i Prespës është një nga parqet e para kombëtare të krijuara në Shqipëri pas ndryshimit të sistemit në vitin 1992, duke përfshirë territoret që përfshihen në 2-ujëmbledhëset e Liqeneve të Prespës (Prespa e Madhe dhe e Prespa e Vogël).

Aktualisht, përgjatë viteve 2011-2015 u hartua Plani i Parë i menaxhimit të këtij Parku për 10 vitet pasuese 2014-2024, me qëllim ruajtjen dhe menaxhimin e vlerave biologjike, kulturore dhe të te pesazhit që ky territor mbart.

Gjatë asaj perudhe u vërejt se kërcënimet më të qënësish në Park ishte mbishfrytëzimit i pyjeve dhe kullotave nga blegtorja, sidomos delet dhe dhitë dhe nga njerëzit brenda dhe jashtë Parkut Kombëtar ku nevoja për dru zjarri ka dëmtuar pyjet dhe ka krijuar formacione pyjore të ngjashme me shkurret.

Dis probleme komunitare mbeten gjithashtu ende pa u zgjidhur si ajo e popullsisë njerëzit brenda parkut kombëtar kanë nevojë për sigurimin e druve të zjarrit për të përballuar kushtet e vështira të dimrit për shkak të mungesës së zgjidhjeve alternative, në një kohë kur peshkimi kontrollohet më mirë dhe ende shërben për sigurimin e të ardhurave për peshkatarët e licencuar nga komunitet e fshatrave përreth Liqeneve.

Vlerat floristike të Parkut janë evidentuar në punimet e mëparshme si :

Shuka, L. (2010): *Viola eximia*, a globally endangered species, nëë for the Albanian flora. BALËOIS, 2010. Ohrid Macedonia. 25-29 May. Abstract Book. V. II. p. 457.

Shuka, L., Malo, S., (2010): The transboundary important plant areas as conservation units of European green belt (Eastern Albanian zone). *Journal of Environmental Protection and Ecology*. Vol.11, (3): 866–874. ISSN 1311-5065.

Shuka, L., Dieterich, T., Mersinllari, M., Matevski, V. (2013): Flora and Vegetation of the Prespa National Park, a critical vieë after tëo-year intensive field investigation. Book of Abstracts of Regional International Conference: -The System “Prespa Lakes-Ohrid Lakes” the Actual State, -Problems and perspective. Struga 27-29 October, p. 34.

Dieterich, T., Shuka, L., Mersinllari, M., Matevski, V. & Renata, C. (2013): Grasslands and Flora of the Dry and Ivani Mountain in the Prespa National Park of Albania. Book of Abstracts of Regional International Conference: -The System “Prespa Lakes-Ohrid Lakes” the Actual State, -Problems and perspective. Struga 27-29 October, p. 34.

Malo, S. & Shuka, L. (2013): Distribution of *Colchicum doerfleri* Halácsy, *Colchicum triphyllum* Kunze and *Colchicum bivonae* Guss., in Albania, IJEES, V. 3/2, p. 273-278.

Shuka, L., Xhulaj, M. (2013): *Iris variegata* L. and *Iris pumila* subsp. *attica* (Boiss. & Heldr.) K. Richt, tëo nëë taxa for the flora of Albania. *BSHN (UT)*, Nr.15: 172-18.

Shuka, L., Kit Tan. (2013): Nëë records for Albania based on taxa from the Prespa

Plani i Menaxhimit për vitet 2014-2024 synon të mbrojë ekosistemet dhe funksionimin e tyre për të ofruar shërbimet e tyre për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme të njerëzimit brënda hapsirës së PK Prespa.

Pavarësisht sa më sipër, Plani ekzistues i Menaxhimit nuk mund të sigurojë mbrojtjen e vlerave biologjike dhe të peisazhit të Ekosistemit Natyror Prespa për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur gjatë 6-viteve të fundit jo vetëm në drejtim të organizimit Administrativ të territorit, por edhe për shkak të mos konsiderimit të tij si një ekosistem i tërë, ku të përfshihen edhe territoret e shtrira në shpatet perndimore të Malit të Thatë, teritore të cilat tani ndodhen nën organizimin administrativ të Bashkisë Maliq dhe Pogradec, ashtu si kundër territori i Liqeneve të 2-Prespave ndodhet nën juridiksionin organizativ të Bashkive Pustec (Prespës) dhe Bilisht.

Ndikimi negativ në mbikullotje në kullotat alpine dhe subalpine të shpateve perndimore, zjarret si dhe fenomenet erozive në këtë pjesë të Malit të Thatë, kërkojnë që edhe ky territor të ndryshojë menyrën e menaxhimit të tij nga ana e Bashkive përgjegjëse të Maliqit dhe Pogradecit.

Nevoja e rishikimit të Planit të menaxhimit të PK Prespë si dhe shpateve perndimore të Malit të Thatë është e diktuar edhe nga vlerat e reja të zbuluara gjatë 6-viteve të fundit në Ekosistemin Natyror të Prespës dhe Malit të Thatë, një pjesë e të cilave është e përmbledhur në publikimet e mëposhtme :

Mahmutaj, E., Shuka, L., Xhulaj, M., Hoda, P., Mersinllari, M. (2015): Rare and Endemic Plants in the Southern Mountain Ecosystems of Albania, their Threats and Diversity. *Albanian Journal of Agricultural Sciences*. 14(1): 1-10.

Wagenitz, G., Bergmeier, E., Gregor, T., Meierott, L., Shuka, L., Tan. K. (2018): A synopsis of the *Centaurea soskiae* and *triniifolia* groups (*Centaurea* sect. *Acrolophus*) in the Prespa area and Northern Pindos. *Phytotaxa*, 348 (2): 77–89.

Pacifici, M., Attorre, F., Martellos, S., Bego, F., De Sanctis, M., Hoda, P., Meço, M., Rondinini, C., Saçdanaku, E., Salihaj, E., Scepi, E., Shuka, L., Ghiurghi, A. (2018): BioNNA: the Biodiversity National Network of Albania. *Nature Conservation*, 25, 77-88.

Zakkak, S., Radović, A., Panitsa, M., Vassilev, K., Shuka, L., Kuttner, M., Schindler, S., Kati, V. (2018): Vegetation patterns along agricultural land abandonment in the Balkans. *Journal of Vegetation Science*. 29 (5): 877–886.

Shuka, L. & Matevski, V. 2018. *Festuca galicicae*. The IUCN Red List of Threatened Species 2018: e.T13165254A18609722. <http://dx.doi.org/10.2305/IUCN.UK.2018-1.RLTS.T13165254A18609722.en>

Shuka, L., Matevski, V. & Karamplianis, T. (2018): *Crocus cvijicii*. The IUCN Red List of Threatened Species 2018: e.T13160401A18613640. <http://dx.doi.org/10.2305/IUCN.UK.2018-1.RLTS.T13160401A18613640.en>.

Për sa më sipër, Shoqata ILIRIA propozon që në rishikimin e Planit të Menaxhimit të PK Prespë dhe në shpatet perndimore të Malit të Thatë të administruara nga Bashkia Maliq të përfshihen zonat si më poshtë :

1. Brënda territorit të PK Prespë, shpatet në krahun e majtë në hyrje të Liqenit të Prespës së Vogël dhe vija breg-liqenore në Gadishullin e Gollomboçit, aktualisht të dyja të përfshira në zonën e përdorimit tradicional, dhe përfshirjen e tyre në Zonën Korë për shkak të prezencës së disa specieve endemike me areal të kufizuar përhapjeje si *Centaurea shumkana* Kit Tan, Shuka & Wagenitz, *Centaurea soskæ* subsp. *albida* Kit Tan, Shuka & Wagenitz dhe *C. galicicæ* Micevski (kjo e fundit nuk është vëzhguar gjatë 2-viteve të fundit).
2. Rishikimi i përfshirjes së shpateve shkëmbore mbi Zvezdë, tunelet e Shëngjergjit dhe Bregasit dhe pjesës së sipërme ose Buzës së Koritës brënda PK të Prespës nën kategorinë, Zonë e Përdorimit të qëndrueshëm, për shkak të prezencës së lartë të bimëve endemike, subendemike dhe vegjetacionit të saj specifik, një përzierje e bimësisë mesdhetare me atë alpine (shih figurën 1, 2 dhe 3). Mbi rëndësinë e kësaj zone do të shkruhet më poshtë, për shkak se aktualisht ajo është nën administrimin e Bashkisë Maliq.

Rekomandime mbi ndryshime në menyrën e menaxhimit të territorit të Malit të Thatë dhe territoreve të tij brënda PK Prespë, që mbulohen nga Bashkia Maliq.

Mali i Thatë në tërësinë e tij bashkë me pjesën e shtrirën në PK Prespë dhe nën administrimin e Bashkisë Pustec, përbën një ekosistem të rëndësishëm natyror me rëndësi jetike për botën bimë dhe shtazore, si një zonë tranzitore midis 2-rajoneve fitogjeografike, atij Mesdhetar dhe Alpin.

Megjithatë shpatet perndimore të Malit të Thatë ose ato që shtrihen nën administrimin e Bashkisë Maliq dhe Pogradec, mbeten ende të pa studiuar nga pikpamja e florës dhe bimësisë, ajo përbën një territor me rëndësi të madhe floristike. Rëndësi e cila rritet edhe më shumë kur mendon që kemi të bëjmë me një zonë gëlqerore, karstike dhe të thatë.

Nga studimet sporadike të kryera nga ana e Shoqatës ILIRIA, rezulton se disa specie të rëndësishme të florës sonë e kanë territorin e tyre të shtrirje në sipërfaqe shumë të vogla vetëm në shpatet perndimore të Malit të Thatë. Ndër to mund të përmenden *Allium albanicum* Brullo, C. Brullo, Cambria, Giusso & Salmeri, *Chamaecytisus pseudojankæ* Pifkó et Barina, *Centaurea soskæ* Hayek ex Košanin, *Crocus cvijicii* Kusanin, *Dianthus galicicæ* Micev., *Festuca galicicæ* Markgr.-Dann., *Sempervivum ciliosum* Craib, *Hesperis theophrasti* Borb., *Iris pumila* subsp. *attica* (Boiss. & Heldr.) K.Richt, *Edraianthus horvatii* Lakušić dhe *Oxytropis purpurea* (Bald.) Markgr., gjenden vetëm midis Malit të Thatë dhe Galicicës fqinje të territorin Maqedon.

Për këtë arsye ato konsiderohen edhe si specie endemike lokale të këtij ekosistemi natyror. Disa prej lokaliteteve të vendndodhjes së tyre gjenden jashtë territorit aktual të PK Prespë.

Në Malin e Thatë gjenden edhe disa specie me përhapje më të gjerë, të cilat të vetmin vendndodhje në Shqipëri e kanë në Malin e Thatë, si *Astragalus mayeri* Micev., *Micromeria cristata* (Hampe) Griseb. subsp. *kosaninii* (Šilić) Greuter & Burdet, *Hesperis theophrasti* Borb., *Iris pumila* subsp. *attica* (Boiss. & Heldr.) K.Richt, *Phlomis herba-venti*

L. ose *Oxytropis dinarica* (Murb.) Wettst. subsp. *weberi* Chrtek & Chrtková. Në shpatet e thepisa mbi tunelet e Shëngjergjit ndodhet gjithashtu një subpopullatë shumë e vogël e sherebelës (*Salvia officinalis*) (Tabela 1). Njera prej specieve Bishtpelëza e Galicicës (*Festuca galicicae* Vulnerable B1ab(ii,iii)+2ab(ii,iii)), është e vlerësuar si e rrezikuar në nivel global dhe shumica e lokalitetve të saj ndodhen mbi Buzën e Koritës.



Figura 1. Efektet e mbikullotjes në zonën alpine të Malit të Thatë.

Në këto kushte, kur kërkohet jo vetëm ruajtja e specieve të rralla dhe të rrezikuara, ruajtja e habitateve të rëndësishme brënda të njëjtit ekosistem, autoritetet administruese të territorit të mësipërm duhet të ndryshjnë menyrën e menaxhimit të tij.

- Për sa më sipër, me qëllim mbrojtjen e disa specieve të rralla dhe të rrezikuara Shoqata ILIRIA i propozon PK Prespë që të përfshijë në rishikimin e Planit të Menaxhimit të Parkut dhe përfshirjen e faqeve të thepisa shkëmbore në anën e majtë në, hyrje të Liqenit të Prespës së Vogël dhe ndryshimin e menaxhimit të sipërfaqes së shënuar me të zezë (Figura 2,3 dhe 4) nga Zonë e Përdorimit Tradicional në Zonë Qëndrore. Po kështu në këtë territor të përfshihet edhe një pjesë e Gadishullit të Gollomboçit (Figura 3).



Figura 2. Zona e vijëzuar, për të cilën kërkohet ndryshimi i zonimit në Liqenin e Prespës së Vogël.



Figura 3. Zona e vijëzuar, për të cilën kërkohet ndryshimi i zonimit në Gadishulli i Gollomboçit, Liqeni i Prespës së Madhe.

Nevoja e rishikimit ose ndryshimit të menyrës së menaxhimit të territorit të Malit të Thatë, aktualisht jashtë PK Prespë, është edhe më emergjente. Kjo për shkak edhe të kushteve e specifikave natyrore dhe klimatike të Malit të Thatë, mal mjaft i ndikuar nga thatësira, erozioni dhe në disa raste edhe i zjarret, ti cilat nën efektin e mbikullotjes e kanë përkeqësuar ekosistemin natyror të tij.

Për këtë arsye, Ne i sygjerojmë Bashkisë Maliq që:

- Territori shkëmbor, gëlqeror mbi Fshatin Zvezdë, Shengjergj deri mbi fshatin Bregas dhe kullotat mbi Buzën e Koritës të mos jepen për kullotje dhe të merret nën mbrojtje për të ndaluar prerjet dhe mbrojtur ato nga zjarret.
- Bashkia të shikojë mundësinë e përfshirjes së këtij territori (Figura 4) brënda PK Prespë-Mali i Thatë.
- Kullotat që ndodhen mbi Buzën e Koritës të menaxhohen në menyrë të qëndrueshme dhe me grafik sipas udhëzimeve të mëposhtme, nëse nuk përfshihen në PK Prespë.



Figura 4. Zona e vijëzuar dhe e pandërprerë e cila strehon specie dhe habitate të rëndësishme, me interes ruajtje që propozohet ose ti shtohet PK Prespë, ose të ndryshojë Menyrën e Menaxhimit nga Bashkia Maliq.

Për të mbrojtur kullotat alpine të Malit të Thatë, jashtë propozimit të figurës 6, të aplikojë nëpërmjet Barinjëve një regjim kullosor me parcela horizontale dhe të alternuara si më poshtë:

- Të ndalojë fillimin e kullotjes në lartësitë 1,200-1,500 m para datës 15 Maj,
- Të ndalojë fillimin e kullotjes në lartësitë 1,500-1,900 m para datës 1 Qershor,
- Të ndalojë fillimin e kullotjes në lartësitë mbi 1,900 m para datës 1 Korrik, fazë në të cilën bimësia fillon lulëzim/frutifikimin për të lejuar rritjen e barit dhe shmangur erozionin por edhe krijimin e biomasës së domozdoshme për kullotje.

Në të gjitha rrastet të detyrojë Barinjtë, nëpërmjet lejeve të kullotjes që të zbatojnë kullotjen e alternuar në parcela të ndryshme, njëkohësisht tju bëjë me dije vlerat e rralla biologjike sipas vendndodhjes të tyre të dhënë në tabelën 1.

Tabela 1. Lista e specieve me interes ruajtje në Malin e Thatë				
Emri latin i Bimës	Vendndodhja	x	y	Lartësia (m)
<i>Chamaecytisus pseudojankae</i> Pifkó et Barina	Kurrizi mbi Buzën e Koritës			2,028
	Mali i Thatë, mbi Zvezdë	40.74774	20.86148	1,830
	Buza e Koritës			1,474
	Mbi Podgorie			1,900
	Mbi Bratomirë	40.846051	20.816239	1,580
	Mbi Djellas	40.832314	20.879503	1,810
	Mali i Ivanit	40.73398	20.894763	1,600
	Mali i Thatë, Pikina Voda	40.899904	20.850996	1,580
	Mbi Pikina Voda	40.894846	20.847161	1,820
	Mbi Stanin e Pikina Voda	40.892128	20.846811	1,940
	Pllaja e Pusit	40.880946	20.833835	2,150
	Mali i Thatë, Maja e Ballamaqit	40.794019	20.846561	1,900
<i>Crocus cvijicii</i> Kosanin	Kudo në lartësitë mbi 1800 m			
<i>Allium albanicum</i> Brullo, C. Brullo, Cambria, Giusso & Salmeri	Mali i Thatë, mbi Podgorie	40.846095	20.816546	1,630
<i>Festuca galicicae</i> Markgr.-Dann.	Sheshi i Rinise			1,800
<i>Festuca galicicae</i> Markgr.-Dann.	Në veri të Sheshit të Rinisë			1,850
<i>Festuca galicicae</i> Markgr.-Dann.	Në veri të Sheshit të Rinisë			1,875
<i>Festuca galicicae</i> Markgr.-Dann.	Në juf të Majë së Pusit			1,950
<i>Festuca galicicae</i> Markgr.-Dann.	Pllaja e Pusit	40 52.199	20 51.113	2,186
<i>Festuca galicicae</i> Markgr.-Dann.	Nën Buzën e Koritës	40 47.901	20 51.138	1,905
<i>Festuca galicicae</i> Markgr.-Dann.		40 47.294	20 50.670	1,900
<i>Festuca galicicae</i> Markgr.-Dann.	Pjesa jugore e Malit të Thatë	40 49.553	20 51.226	1,848
<i>Festuca galicicae</i> Markgr.-Dann.		40 51.900	20 50.960	2,141
<i>Festuca galicicae</i> Markgr.-Dann.	Pjesa jugore e Malit të Thatë	40 49.581	20 51.213	1,835
<i>Festuca galicicae</i> Markgr.-Dann.	Pjesa jugore e Malit të Thatë	40 49.615	20 51.173	1,817
<i>Festuca galicicae</i> Markgr.-Dann.	Pjesa jugore e Malit të Thatë	40 45.884	20 51.008	1,900
<i>Festuca galicicae</i> Markgr.-Dann.	Në veri të Pllajës së Pusit	40 51.673	20 50.544	
<i>Sempervivum ciliosum</i> Craib.	Pjesa jugore e Malit të Thatë	40 45.942	20 50.994	1,907
<i>Sempervivum ciliosum</i> Craib.	Pjesa jugore e Malit të Thatë	40 45.884	20 51.008	1,900
<i>Sempervivum ciliosum</i> Craib.	Pjesa qëndror e Malit të Thatë	40 51.667	20 51.923	1,686
<i>Sempervivum ciliosum</i> Craib.	Pjesa qëndror e Malit të Thatë	40 49.049	20 51.862	1,912
<i>Sempervivum ciliosum</i> Craib.	Pjesa qëndror e Malit të Thatë	40 53.762	20 50.333	2,108
<i>Sempervivum ciliosum</i> Craib.	Në veri të Pllajës së Pusit	40 51.673	20 50.544	1,941

<i>Sempervivum ciliosum</i> Craib.	Shpatet e Shëngjergjit	40.772923	20.828021	1,050
<i>Sempervivum ciliosum</i> Craib.	Shpatet e Shëngjergjit	40.754732	20.838807	1,100
<i>Sempervivum ciliosum</i> Craib.	Maja e Ballamaqit	40.795311	20.848921	1,920
<i>Sempervivum ciliosum</i> Craib.	Buza e Koritës	40.766089	20.848753	1,860
<i>Sempervivum ciliosum</i> Craib.	Ivani Mt	40 44.008	20 54.116	1,768
<i>Sempervivum ciliosum</i> Craib.	Pjesa jugore e Malit të Thatë	40 47.908	20 51.155	1,892
<i>Micromeria cristata</i> (Hampe) Griseb. subsp. <i>kosaninii</i> (Šilić) Greuter & Burdet	Shpatet e Shëngjergjit	40.777288	20.826826	1,080
<i>Centaurea soskai</i> Hayek ex Košanin	Shpatet e Shëngjergjit	40.772923	20.828021	1,050
<i>Centaurea soskai</i> Hayek ex Košanin	Shpatet e Shëngjergjit	40.754732	20.838807	1,100
<i>Fritillaria graeca</i> Boiss -Etsprun.	Në perëndim të Buzës së Koritës			1,905
<i>Hesperis theophrasti</i> Borb.	Mbi Zvezdë	40.742378	20.86218	1,200
<i>Hesperis theophrasti</i> Borb.	Mbi Shëngjergj	40.753343	20.845116	1,360
<i>Iris pumila</i> subsp. <i>attica</i> (Boiss. & Heldr.) K.Richt				
<i>Phlomis herba-venti</i> L.	Mbi Podgorie			1,320
<i>Melampyrum heracleoticum</i> Boiss. & Orph.	Mbi Bregas	40.804231	20.841129	1,600
<i>Convallaria majalis</i> L.	Mbi Bregas	40.804231	20.841129	1,600
<i>Edraianthus horvatii</i> Lakušić	Mali i Thatë, gropat e Palates			2,220
<i>Edraianthus horvatii</i> Lakušić	Pllaja e Pusit			2,120
<i>Edraianthus horvatii</i> Lakušić	Në veri-perëndim të Buzës së Koritës			1,892
<i>Astragalus mayeri</i> Micev.	Pjesa jugore e Malit të Thatë	40 45.942	20 50.994	1,907
<i>Salvia officinalis</i> L.	Shpatet e Shëngjergjit	40.777288	20.826826	1,080
<i>Oxytropis dinarica</i> (Murb.) èettst. subsp. <i>weberi</i> Chrtek & Chrtková	Mbi Stanin e Pikina Voda	40.892128	20.846811	1,940
<i>Oxytropis dinarica</i> (Murb.) èettst. subsp. <i>weberi</i> Chrtek & Chrtková	Pllaja e Pusit	40.880946	20.833835	2,150
<i>Oxytropis dinarica</i> (Murb.) èettst. subsp. <i>weberi</i> Chrtek & Chrtková	Maja e Pllajës së Pusit	40.880946	20.833835	2,200
<i>Oxytropis purpurea</i> (Bald.) Markg	Pjesa qëndror e Malit të Thatë	40.867263	20.85819	1,940
<i>Oxytropis purpurea</i> (Bald.) Markg	Pjesa qëndror e Malit të Thatë	40.867955	20.845726	2,060
<i>Solenanthus scardicus</i> Bornm.	Kullotat alpine mbi Bletas	40.894415	20.833893	1,920

Ky draft propozim është realizuar nga studimi në kuadër të projektit :
«SRE of Prespa NP –Assessment, protection and *in-situ/ex-situ* conservation, through involvement of young professionals».

Në zbatim nga Shoqata ILIRIA (Shqiperi) dhe Research Centre for Environment and Materials, Akademia e Shkencave të Maqedonisë së Veriut. Financuar nga PONT dhe CEPF.